

Nga shkolla në profesion

Një njoftim për prindër

Të dashur prindër

Ju keni një djalë apo vajzë në klasën 7,8,9 ose 10. Djali apo vajza e juaj, duhet të zgjedhë një profesion apo vendosë të vazhdoj një shkollim të mëtutjeshëm.

Si ndihmon shkolla?

Shkolla përgatitë nxënësit e klasës 8 dhe 9, në zgjedhjen e profesionit apo vazhdimin e shkollimit të mëtutjeshëm. Pyetni mësuesen ose mësuesin, se çka bëjnë ata më saktësisht në shkollë.

Si ndihmon Këshillimorja për Profesione¹?

Këshillimorja për profesione ju ofron njoftime dhe biseda personale për nxënës. Kjo ofertë është falas dhe e besueshme.

Shkolla dhe këshillimorja për profesione, në të vërtetë ndihmojnë të rinjtë në zgjedhjen e një shkollimi, mbas përfundimit të klasës së 9 ose 10. Mirëpo, për këtë, puna kryesore dhe përgjegjësia, u mbetet vetë atyre. Djali ose vajza e juaj, duhet që të angazhohet shumë derisa të gjejë një vend për shkollim mbas kryerjes së klasës së 9 apo 10. Për pjesën dërmuese kjo është shumë e vështirë. Shumë nga ata këtë nuk e kanë bërë asnjëherë. Prandaj, në këtë drejtim, ndihma e nënës dhe e babait është tepër e rëndësishme.

Çka duhet të bëjnë vetë të rinjtë?

T'i njohin profesionet

Çfarë profesione ka? Çka bëhet aty? Çka duhet ditur mirë?

- T'i lexojnë përshkrimet e profesioneve, të informohen, të bisedojnë me persona kompetent të Këshillimores për Profesione.
- T'i vizitojnë organizimet informative.
- Të bëjnë Nuhatje/gjurmim² në profesion. Në afatin prej 2 deri 3 ditësh gjatë këtij gjurmimi (nuhatje) në profesion, të rinjtë kanë mundësinë që të njoftohen më mirë me një profesion në një ndërmarrje.

1

Secili kanton e ka së paku nga një Këshillimore për Profesione.

Adresat ju mund t'i merrni në shkollë në komunën tuaj ose në internet: www.svb-asosp.ch

Këshillimorja për Profesione dhe Qendra Informative për Profesione ÇIP është shpesh e njohur me një emër të veçantë ose me një shkurtesë:

Gjermanisht	BIZ, Laufbahnzentrum
Frëngjisht	OP, OSP, OROSP, CIO, CIP, OOF
Italisht	orientamento, UOSP

2

Gjermanisht	Schnupperlehre
Frëngjisht	stage d'information professionnelle; stage en entreprises
Italisht	stage

Shpesh herë, gjatë kësaj kohe, ndërmarrja u bënë verifikimin e të rinjve: përgjegjësit apo përgjegjëset e këtyre ndërmarrjeve, dëshirojnë që t'i njoftim të rinjtë më mirë. Kandidatët të cilët u kanë lënë atyre përshtypje të mira, do të kenë shanse më të mëdha pranimi për një vend shkollimi në ndërmarrjen përkatëse.

Ta njihni vetveten dhe të zgjidhni profesionin apo shkollën

Çka di mirë unë në shkollë, çka kam mësuar gjatë kohës së lirë në familje? (Për shembull: të flas gjuhë të ndryshme, të pastroj, të kujdesëm për fëmijë, të bëj blerje). Cili profesion, cili arsimim më përshtatet mua?

- Të bisedoni me prindër lidhur me profesionet dhe t'i pyesni ata: cila punë më përshtatet mua? Të bisedoni me mësuesin apo mësuesen: A mund ta bëjë unë këtë apo atë punë, çka duhet të dijë unë në lëndët gjuhësore dhe në matematikë? Ku kam zbrazëtira? Si mund të përgatitem në shkollë për një arsimim pas klasës së 9 apo të 10-të?
- Të bëni një takim në këshillimoren për profesione, dhe të pyesni këshilltarin përgjegjës: A jam unë mjaft i përgatitur për profesionin të cilin dëshiroj ta mësoj? Nëse kam zbrazëtira, çka mund të bëjë unë?
- Të zgjidhni një profesion ose shkollim të mëtutjeshëm të përshtatshëm, edhe ti lini hapur 1 deri 2 alternativa/mundësi të tjera.

Të kërkosh një vend për arsimim (sipas rregullave prej vjeshtës së klasës së 9-të)

Ku ka vend për arsimim në të cilin, unë mund të mësoj profesionin të cilin e kam zgjedhur? Ku gjinden shkollat e mëtutjeshme? Çka duhet të bëj që ta gjej një vend për arsimim?

Ai që u përmbahet rregullave të kërkimit të vendit për mësim të profesionit/zejes, shumë më dukshëm ka sukses!

Për pyetje dhe probleme: Bisedoni në shkollë me mësuesin ose mësuesen. Merrni njoftime në këshillimoren për profesione, ose bëni një takim për një bisedë personale.

Zgjedhja e profesionit ose shkollimit të mëtutjeshëm, kërkon kohë që të mendosh, dhe kohë që të ndërmarrësh vendime të ndryshme.

Djemtë dhe vajzat tuaja janë të varur, që ju si prindër t'i përkrahni.

Nga këta shembuj, ju nxirrni përvojë se si mund të ndihmojnë nëna dhe babai.

Të bisedohet me mësues

Laura është në klasën e 8. Ajo nuk bisedon fare në shtëpi, në lidhje me zgjedhjen e profesionit apo të shkollimit të mëtutjeshëm. Ç'po ndodhë, pyesin prindërit. Nëna shkon në shkollë, mbas mësimin dhe e pyet mësuesin, mos Laura edhe në shkollë nuk tregon interesim për zgjedhjen e ndonjë profesioni apo shkolle.

Të jeni të hapur për mundësi të ndryshme

Nikolasi shkon në klasë e 9. Si shumë të rinj edhe ai dëshiron të mësoj informatikën. Ai kërkon vend për mësim të zejes në këtë drejtim, mirëpo çdo herë merr përgjigje negative. Në mbledhje prindësh, prindërit e kuptojnë se për informatikë ka vetëm pak vende për mësim të këtij profesioni. Ata e udhëzojnë Nikolasin që të lajmërohet në këshillimoren për profesione për një bisedë personale. Nikolasi kthehet me një ide të re në shtëpi: Meqenëse ai është i mirë në matematikë dhe i intereson teknika, tani kërkon një vend për mësimin e profesionit si polimekanik (mekanikë e përgjithshme). Ai e di që në këtë

profesion ka të bëjë gjithashtu më kompjuter. Nëse ai dëshiron, pas përfundimit të këtij profesioni, ka mundësi të specializoj informatikën.

Familja është në pritje

„Kur do ti filloj Ahmedi studimet?“, pyesin në shtëpi të afërmit nga fshati. „Në Zvicër është krejt ndryshe nga ajo që ju mendoni“ thonë prindërit e tij. „Ahmedi ka duar të shkathëta dhe i do automjetet. Ai do të bëhet automekanik. Ky është një arsimim i mirë dhe ky profesion i përgjigjet atij. Ne jemi krenar me djalin tonë, që ka arritë kaq shumë. Më në fund nuk është e lehtë, kur dikush e kryen shkollën në gjuhë të huaj“. Si automekanik Ahmedi mund të gjejë punë në mbarë botën!

Mungesa e njohurive gjuhësore

Fatma është një vajzë shumë e zgjuar. Ajo kishte ardhur në Zvicër në moshën 15 vjeçe, dhe ende nuk ka mjaft njohuri të gjuhës që kërkon një arsimim i lartë. Fatma dhe prindërit e saj njoftohen se pas mbarimit të shkollës së detyruar, ajo mund të bëjë një vit shkollë për përgatitje profesionale, një mësim të ulët profesional ose një shkollim të përgjithshëm profesional 2 vjeçar. Për Fatmen dhe familjen e saj e gjithë kjo procedurë është e panjohur. Në të vërtetë, ata duhet që së pari t'i njohin mundësitë. Fatma është gjithashtu e zhgënjyer. Ajo kishte ëndërruar gjimnazin...Prindërit e ngushëllonin atë: „Ty të duhet ndoshta kohë më shumë se sa të tjerëve. Nëse i plotëson zbrazëtirat tua, ti do të bësh një shkollim themelor profesional më kërkesa të larta, dhe ndoshta më vonë do të studiosh. Ti do ta arrish këtë!“

Profesioni ose martesë?

Samira do t'i mbushë së shpejti 16 vjet. Një djalë i ri vjen për vizitë në shtëpi. Ai e pyet babain e Samirës: „A mund të martohem me Samirën?“ Babai i përgjigjet: „Më vjen shumë mirë, që ty të pëlqen Samira. Mirëpo ti e di se ne jetojmë në Zvicër, jeta ndryshon. Këtu është shumë me rëndësi që gratë dhe burrat ta kenë një profesion. Për këtë arsye Samira duhet që së pari ta mësojë një profesion. Më vonë ajo mund të vendosë vetë se a dëshiron të martohet.“

Babai e shoqëron djalin e tij

Leonardi shkon në klasë të vogël. Ai ka gjetur një vend, që të bëjë një nuhatje në profesionin e zdrukthëtarisë. Ai e din se për zejen e zdrukthëtarit duhet t'a bëjë shkollimin themelor profesional i cili zgjatë 2 vjet. Nëse nuhatja/hulumtimi shkon si duhet. Për këtë nuhatje të profesionit, Leonardo është i shqetësuar dhe ndihet i pa sigurtë, sepse nuk e njeh mirë rrugën dhe dëshiron që të jetë i përpiktë. Babai i jap atij guxim: „Ti din shumë për këtë profesion. Përpiku vetë. Ditën e parë do të përcjell deri tek dera e ndërmarjes. Ne do të nisemi me kohë nga shtëpia, nëse na mjafton koha do të bëjmë një shetitje të vogël. Kjo e ndihmon njeriun, ku ai është i shqetësuar.“

Shfrytëzoni lidhjet - miqësitë

Paula është një nxënëse e mirë. Ajo ka nota të mira në frëngjisht, gjermanisht dhe matematikë. Përpos këtyre ajo di të flas, të shkruaj dhe të lexoj portugalisht. Asaj i interesojnë shumë profesione, merr pjesë në shumë organizime informative dhe bënë nuhatje nëpër profesione. Tashmë është e qartë, ajo dëshiron të bëjë shkollën e tregtisë. Paula konkurron në shumë vende, por merr vetëm përgjigje negative. Babai i saj punon në ndërtimtari, dhe i tregon shefit, se vajza e tij kërkon një vend të mësimi të profesionit. „Pyet tek ne në zyrë, ata shkollojnë gjithashtu nxënës“, mendon shefi. „Këtë do ta bëjë unë, poashtu gruaja ime mund të pyes në spitalin ku ajo punon. „Athua kemi ne ndonjë fqinjë që mund të na ndihmonte?“, mendon babai.

Të dashur prindër!

Në qoftë se keni pyetje në lidhje me profesionin e vajzës apo djalit tuaj, mos pritni. Pyetni mësuesin, mësuesen ose në Këshillimoren për Profesione.